



Lypësi kinez i njohur si “mbreti i lagjes Xidan”, pasi më së shpeshti shihet duke kërkuar lëmoshë në atë pjesë të kryeqytetit Pekin, kohë më parë u bë personazh televiziv pasi u zbulua se ai posedon disa banesa dhe makina.

Pasi u zbulua në televizion, shumë njerëz filluan të interesohen se si jeton ky lypës nga Pekini dhe zbuluan se ai është një njeri familjar i cili jeton me nënën dhe dy djem. Nëna e lypësit sipas mediave kineze bartë sasi të mëdha zbukurimesh prej ari, ndërsa fëmijët e tij janë të veshur me rroba të shtrenjta.

Edhe pse ai është edhe më i pasur se shumica e atyre që i japin lëmoshë, njëri prej komentuesve në internet i doli në mbrojtje duke thënë se ajo që e bënë lypësi nuk është kundërligjore, por vetëm është jo etike. Mbreti i lagjes Xidan lyp para duke u lutur dhe mbështetur kokën për trotuar. Pasi mësuam historinë e tij, shumë qytetarë u betuan se më nuk do t'i japin para./koha.mk/